

# KEK SOVA

Gazetë e Korporatës Energjetike të Kosovës

Viti XI nr.103 Janar 2010



*Gëzuar Ditëlindja  
Kosovë!*

**Dell: Qeveria Amerikane në  
vazhdimësi mbështet KEK-un**



Nr.103

janar 2010

Botues: KEK

Departamenti për Komunikime të  
Korporatës

Adresa: Sheshi "Nëna Tereze" nr. 36  
Prishtinë

Tel: +381 38 240 245 lok.226

[www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)

[info@kek-energy.com](mailto:info@kek-energy.com)

Dizajni dhe shtypi: Design House

Në vitin 2009 KEK-u shënoi arkëtim rekord prej 160 milionë eurosh.....	3
Ambasadori i SHBA-së viziton KEK-un .....	4
Synimet dhe objektivat për vitin 2010 në Divizionin e Qymyrit.....	5
TC " Kosova A" nis vitin pa probleme të theksuara.....	6
Në TC "Kosova B" gjendje stabile në prodhim.....	6
Gjatë janarit arkëtohen 15,076,201 euro.....	7
Në Divizionin e Qymyrit u punua në kontinuitet me nevojat e Gjenerimit.....	7
Punëtorët dhe menaxhmenti i KEK-ut ndanë mbi 33 mijë euro ndihmë Shqipërisë	7
Investitorët shfaqën interesim serioz për projektin " Kosova e Re" .....	8
U.S.A ambassador visits KEK .....	9
Stable Conditions of Production in the PP "Kosova B" .....	10
The Coal Division operation was pursuant to the needs of power generation .....	10
15,076,201 Euros Collected During January .....	11
"Kosovo A" starts this year without noted problems.....	11
The Investors showed serious interest for the "Kosova e Re" project.....	12
Realizimi i objektivave - synim permanent .....	13
Projektet themelore fokusohen në regjistrimin e konsumatorëve të përkohshëm dhe atyre paushall .....	14
In memoriam.....	14
Punohet pandërprerë dhe në kushte të jashtëzakonshme.....	15
Sulmohen punëtorët e KEK-ut në detyrë.....	15
Operatori më i vjetër në Prishtinë.....	16
Punëtorja që dëshiron ngritje të performancës së KEK-ut .....	16
Punëtor dhe sportist i dalluar.....	16
Bashkim Paçuku fiton çmimin "Barry Alexander" .....	17
Botime të reja.....	18
KEK-u ka ndihmuar KESH-in duke marrë energji elektrike .....	19

# Në vitin 2009 KEK-u shënoi arkëtim rekord prej 160 milionë eurosh

KEK-u ka arritur rekord të arkëtimit gjatë vitit 2009. Shuma e përgjithshme e arkëtuar është 160 milionë euro. Rekord në vete paraqet edhe muaji dhjetor kur janë arkëtuar 18.6 milionë euro, që është shuma më e lartë e mbledhur brenda muajit ndonjëherë në historinë 60-vjeçare të korporatës.

Arkëtimi gjatë vitit 2009 ishte mbi 20 për qind më i lartë se periudha e njëjtë e një viti më parë, kur ishin arkëtuar 134.5 milionë euro. Bashkë me të hyrat alternative që janë afro 8 milionë, KEK-u në vitin 2009 është bërë kompania numër një në vend në të gjitha aspektet, si nga niveli i të hyrave, prodhimitarisë dhe numrit të të punësuarve.

“KEK-u po shkon fuqishëm drejt stabilizimit dhe vetëqëndrueshmërisë financiare. Falënderoj të gjithë punëtorët e KEK-ut për angazhim maksimal gjatë gjithë vitit të kaluar. Sfida të reja na presin këtë vit dhe objektiv parësor është rregullimi përfundimtar i korporatës”, thotë Arben Gjukaj, Drejtor Menaxhues i KEK-ut.

Rritjes së arkëtimit i ka paraprirë stabilizimi i furnizimit me qymyr, rritja e prodhimit të energjisë elektrike që ka ndikuar direkt edhe në furnizimin me energji elektrike, që është më i miri nga paslufta. Tash e sa muaj KEK-u nuk ka aplikuar fare reduktime, pos në raste të fyteve të ngushta apo të prishjeve eventuale, të cilat po sanohen në afatin më të shpejtë të mundshëm.

Furnizimi ka arritur deri në 1100 megavatë/orë që është rekord tjetër në historinë e korporatës. Konsumatorët kanë harruar zhurmën e agregateve, ndërsa rënia e blloqeve ka kohë që nuk është lajmëruar më në media.

Rregullimi përfundimtar i KEK-ut nënkupton arritjen e arkëtimit 100 për qind, eliminimin e humbjeve komerciale dhe shtrirjen e autoritetit të plotë të korporatës në tërë territorin e vendit, që do të arrihet gjatë javëve në vijim.

KEK-u është i vendosur që t'i trajtojë të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë dhe ky mision i orientimit komercial të korporatës, është i pa kompromis.

Viktor Buzhala

# Ambasadori i SHBA-së viziton KEK-un



Christopher William Dell, Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, më 26 janar 2010 ka vizituar Korporatën Energjetike të Kosovës. Ai është takuar me Kryesuesin e Bordit të KEK-ut, Fadil Çitaku, Drejtorin Menaxhues të KEK-ut, Arben Gjukaj dhe anëtarët e tjerë të menaxhmentit, me ç'rast edhe i ka bërë vizitë minierave dhe termocentraleve tona.

Gjatë vizitës së tij, Ambasadori Dell ka shprehur interesim për përmirësimet e fundit që menaxhmenti i KEK-ut ka bërë në performancën e kompanisë, që kanë rezultuar në stabilizimin e furnizimit me energji elektrike në Kosovë, të cilën gjë qytetarët e Kosovës nuk e kanë shijuar që nga viti 1999.

Ai është informuar që KEK-u ka punuar zellshëm gjatë dy viteve të fundit për të hapur Minierën e Sibovcit Jugperëndimor, që do të nisë prodhimin e thëngjillit para afatit të paraparë, nga mesi i vitit 2010. Ambasadori Dell, gjithashtu është informuar edhe me faktin e riaktivizimit të njësisë A4 të TC "Kosova A", një hap ky që ka shtuar kapacitetet e nevojshme për t'i furnizuar konsumatorët e Kosovës me energji elektrike.

Sa i përket anës komerciale të operimeve, KEK-u është përqendruar në përmirësimin e rrjedhjes, faturimit dhe arkëtimit të energjisë elektrike. Ambasadori Dell u shpreh i kënaqur kur u informua se KEK-u ka përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme arkëtimin e konsumatorëve të tij, nga 51 për qind e energjisë në dispozicion në vitin 2006, në 65 për qind në vitin 2009 (një përmirësim prej 30 për qind). Kjo, po ashtu, ka dërguar në rritjen e arkëtimit gjatë të njëjtës periudhë prej 96 milion euro në 160 milion euro. Këto përmirësime kanë qenë fillimisht si rezultat i përmirësimit të kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes së performancës së punëtorëve në baza individuale. Përveç kësaj, tani janë ndërmarrë edhe masat për fuqizimin dhe zgjerimin e kontrolleve të brendshme të KEK-ut në vazhdimësi, në përpjekje për të përmirësuar afarizmin dhe efikasitetin e kostos, performancën e punëtorëve dhe zvogëlimin e korrupsionit.

"Kjo vizitë e miqve tanë amerikanë është një përkrahje e madhe dhe një motiv shtesë për ne që të vazhdojmë punën për avancimin e korporatës në nivele edhe më të larta", tha Drejtori Menaxhues i KEK-ut, Arben Gjukaj.

Një pikë tjetër e rëndësishme për Menaxhmentin e KEK-ut në vitin 2009 ishte rregullimi i raporteve të KEK-ut me bashkësitë minoritare. Deri më sot, KEK-u ka realizuar marrëveshje për rregullimin e shërbimit me energji elektrike me të gjitha bashkësitë minoritare deri në jug të Lumit Ibër, që nënkupton se konsumatorët në këto zona tani janë regjistruar si konsumatorë të KEK-ut dhe kanë filluar të paguajnë për energjinë elektrike që e shpenzojnë. Kjo është një arritje historike, meqë KEK-u nuk kishte mundësi të arkëtonte apo operonte në këto zona për 10 vjet me radhë.

Në 12 muajt në vijim, KEK-u jo vetëm që do të punojë në avancimin e sukseseve të fundit, por do të përshpejtojë përgatitjet për ristrukturimin dhe shturjen ligjore të afarizmit të distribuimit, proces i cili është në zhvillim e sipër, dhe do të ndajë asetet e tij të minierave dhe gjenerimit, gjithnjë në pajtim me politikën e Qeverisë për përgatitjen e kompanisë për privatizim.

Qëllimi i theksuar në vazhdimësi i Shteteve të Bashkuara është që t'i ndihmojë Kosovës në krijimin e një shteti stabil, demokratik dhe ekonomikisht të qëndrueshëm në Evropë. Programet e asistencës së Qeverisë së SHBA-ve janë të projektuara për të ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi, duke punuar në fushat kryesore, si atë të energjisë. Qeveria e SHBA-ve ka përkrahur Sektorin e Energjisë në Kosovë që nga të viti 1999. Kjo përkrahje po vazhdon aktualisht përmes këshilltarëve të saj me përvojë në KEK, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Në vlerësimin e fundit strategjik, USAID-i parasheh mbështetjen e vazhdueshme të Sektorit të Energjisë, në mënyrë që t'i mundësojë Kosovës një furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike në funksion të rritjes së zhvillimit ekonomik.

**Departamenti për Komunikime**



# Synimet dhe objektivat për vitin 2010 në Divizionin e Qymyrit

**N**ë këtë divizion aktivitetet për këtë vit kryesisht do të fokusohen në prodhimin e djerrinës dhe të qymyrit, në investimet kapitale dhe në infrastrukturë, thotë Adil Januzi, drejtor ekzekutiv i këtij divizioni. Aktivitetet në prodhim do të zhvillohen në Sektorin e Lindjes, të Perëndimit, të Sitnicës dhe në Sibovcin Jugperëndimor.

Në Sektorin e Lindjes në Sistemin e Djerrinës do të bëhet definimi i pajisjeve kryesore xehetare dhe i shiritave transportues, që do të punojnë në këtë sistem deri në përfundimin e masave të djerrinës në mes dy mihjeve, si dhe kyçja e pajisjeve kryesore xehetare sipas elaboratit të hartuar nga Instituti i Xehetarisë. Masat e djerrinës në minierat ekzistuese do të largohen me Sistemin e Lindjes. Hapësira e palosjes në perëndim kërkon elaborat të veçantë për palosjen e masave të parapara për këtë hapësirë.

Ndërsa, vazhdon Januzi, në Sektorin e Qymyrit do të bëhet definimi i pajisjeve kryesore xehetare, që do të mbesin në këtë sektor, i pajisjeve që do të lirohen nga ky sektor, për t'u kyçur në Sibovcin

Jugperëndimor, si dhe implementimi i elaboratit të hartuar nga Instituti i Xehetarisë për dislokimin e këtyre pajisjeve në Sibovcin Jugperëndimor. Gjithashtu, Instituti i Xehetarisë është i obliguar që të hartojë elaboratin për largimin e ujërave nga kuotat e fundme dhe nga sektori perëndimor, si dhe elaboratin për mbrojtje nga zjarri.

Në Sektorin e Sitnicës, në sistemin e djerrinës do të punohet harmonogrami për riparimin e E-6 dhe kyçja e tij sipas planit operativ, analizimi i teknologjisë së punës për ESH 10/70 në këtë sektor, si dhe transportimi i tij në Sibovcin Jugperëndimor.

Në Sektorin e Sibovcit Jugperëndimor sistemi punon sipas tri planeve. Sipas planit A implementohet teknologjia e palosjes sipas elaboratit për palosjen e sektorit perëndimor. Njëherësh, hartohet edhe elaborati për largimin e ujërave nga fusha e kësaj miniere, ku bëhet edhe incizimi i gjendjes dhe propozimi i masave të nevojshme. Gjithashtu, përcillet gjendja e zjarreve në terren dhe propozimi i masave të nevojshme për sanimin e tij.

Sipas planit B hartohet elaborati për palosjen e masave të zhvendosura me E-7B dhe E-8.B. Ndërsa, sipas planit D bëhet definimi i pajisjeve kryesore xehetare, që do të kyçen në këtë sistem, si dhe hartimi i termin-planit për aktivitetet e nevojshme për aktivitetet e nevojshme për kompletimin e këtij sistemi.

Në vazhdim, Januzi thotë se në investimet e planifikuara për këtë vit janë paraparë të realizohen këto projekte: Riparimi i E-8 M, i E-9 M, i P-3 M, i stacionit veprues të sistemit II të djerrinës, i makinave të kombinuara dhe riparimi i shiritave të qymyrit në Sibovcin Jugperëndimor. Sa i përket infrastrukturës, për këtë vit është paraparë asfaltimi i rrugës nga HZ.01 deri te vendriparimi i pajisjeve kryesore xehetare në Bardh, riparimi i asfaltit ekzistues nga HZ. 01 deri te hyrja e Mirashit, shtruarja e asfaltit të ri nga trafoja në jug të Mirashit deri te vendriparimi në Bardh, si dhe ndërtimi i një muri mbrojtës në pjesën perëndimore të Bardhit pranë rrugës përgjatë SHT D 1.1 dhe një D.1.2. përfundoi Januzi.

B. Rudhani



## TC "Kosova A" nis vitin pa probleme të theksuara

**G**jatë muajit janar puna e blloqeve në TC "Kosova A" ka qenë pa probleme të theksuara dhe pa ndalesa. Kjo është arritur falë ndërhyrjeve me kohë të punëtorëve në eliminimin e prishjeve dhe mangësive të ndryshme që janë paraqitur në të gjithë sektorët e prodhimit të energjisë elektrike, tha Ismail Simnica, ekspert për çështje teknike në këtë termocentral. Gjatë këtij muaji kryesisht në këtë termocentral në funksion kanë qenë dy blloqe, kurse blloku tjetër ka qenë rezervë. Blloku A3 ka bërë 300 orë pune dhe ka dhënë prodhim prej 21045 megavat orë energji elektrike, kurse blloku A5 ishte në procesin e prodhimit 458 orë dhe ka dhënë prodhim prej 57813 megavat orë energji elektrike.

Në bllokun A4 kryesisht është punuar në ndërrimin e pjesës rregulluese dhe komanduese të filtrave elektrikë, të cilët gjatë këtyre ditëve të punës së bllokut janë në provë e sipër. Ato përcillen nga ekspertët tanë dhe në bashkëpunim me ata të firmës "Siemens", prodhuesit të këtyre pajisjeve. Në këtë bllok gjithashtu janë ndërruar mbrojtjet e gjeneratorit, transformatorit të bllokut T4 dhe transformatorit të shpenzimeve vetanake T4A. Blloku ka startuar më 25 janar dhe gjatë testimit këto mbrojtje janë treguar të suksesshme, domethënë, kanë reaguar sipas të dhënave projektuese të këtyre pajisjeve. Mbrojtjet janë të prodhim i markës "SIPROTEC" nga "Siemens".

Termocentrali "Kosova A" gjithsej ka prodhuar 116, 828 MW orë energji elektrike.

Blloqet A3 dhe A5 nuk patën asnjë rënie të dhunshme, kurse blloku A4 rëniet i kishte gjatë testimit të mbrojtjeve të instaluar gjatë këtij muaji.

Blloqet e këtij termocentrali patën ndalje të planifikuara në kohën kur në Shqipëri kishte teprica të ujit dhe Kosova furnizohej nga hidrocentralet e saj me energji elektrike, thotë Ismail Simnica.

D.Shala



## Në TC "Kosova B" gjendje stabile në prodhim

**N**ë blloqet B1 dhe B2, plani i prodhimit të energjisë elektrike për muajin janar 2010 është realizuar, madje edhe tejkaluar. U punua me një përkushtim të madh për arritjen e rezultateve, duke iu përmbajtur kushteve teknike që kishin këto dy blloqe.

Gjatë muajit janar, dinamika e punës në të dy blloqet ishte mjaft stabile, ngase pati vetëm një rënie, ndërsa shkyçje nuk pati fare.

Sipas personelit nga Shërbimi i Analizave të termocentraleve, për muajin janar në të dy blloqet ishin planifikuar të prodhoheshin në gjenerator 313.038 megavat, nga të cilat u realizuan 358,365 megavat orë energji elektrike. Nga ky prodhim bruto, harxhimet e përgjithshme vetanake ishin 38336 megavat, andaj prodhimi neto për muajin janar në bllokun B1 ishte 153,671 megavat energji elektrike apo 103.4 për qind, ndërsa në bllokun B2 u realizuan 166,358 megavat energji elektrike apo 101.2 për qind, përkatësisht në të dy blloqet u arrit të prodhohen 320, 030 megavat orë energji elektrike apo 102.2 për qind nga plani i paraparë.

Për prodhimtarinë e kësaj energjie elektrike gjatë janarit të këtij viti, në furrat e termocentraleve u dogjën 260,144 tonë qymyr, thuhet në këtë shërbim. Në të dy blloqet brenda këtij muaji janë harxhuar 590.7 tonë mazut për nevoja të domosdoshme, për instalime të objektit, për ristartime dhe për nevoja tjera.

Pas një pune të gjatë dhe një dimri të rëndë, kur punohet, duke rrezikuar insalimet prodhuese, është prodhuar energji elektrike për të furnizuar me energji elektrike popullatën. Në ngrica të ulta dhe të vazhdueshme, është e kuptueshme se blloqet B1 dhe B2 kanë nevojë për riparime gjatë kësaj vere, thonë inxhinierët në prodhim.

B. Rudhani

## Gjatë janarit arkëtohen 15,076,201 euro



Edhe gjatë muajit janar të këtij viti përpjekjet e Divizionit të Furnizimit për të arkëtuar sa më shumë mjete financiare për energjinë e shpenzuar elektrike nga konsumatorët nuk janë ndalur.

Nexhmedin Gashi, menaxher i Departamentit të Faturimit tha se gjatë këtij muaji kemi këto rezultate të arkëtimit nëpër distriktet e Kosovës: Prishtina 4,524,372, Prizreni 2,189,961, Peja 1,448,434, Ferizaj 1,605,032, Gjilani 1,262,496, Mitrovica 744,972 dhe Gjakova 1,315,588 euro.

Shuma e përgjithshme në CCP është 13,090,855, ndërsa në 110 kV është 1,985,346 euro. Pra, gjatë muajit janar të vitit 2010 janë arkëtuar gjithsej 15,076,201 euro, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, këtë muaj arkëtimi është për 22,13 për qind më i lartë, tha Gashi.

**F. Ramadani**



## Në Divizionin e Qymyrit u punua në kontinuitet me nevojat e Gjenerimit

**G**jatë muajit janar të këtij viti në minierat tona u hoqën sasi të bollshme të djerrinës si dhe u nxorën sasi të mjaftueshme të qymyrit për nevojat e termocentraleve.

Sipas Departamentit të Gjeodezisë Inxhinierike të këtij divizioni, në Departamentin e Djerrinës për këtë muaj u planifikuan të largohen rreth 660 mijë tonë metra kub djerrinë, kurse deri në fund të janarit u hoqën mbi 437 mijë tonë apo rreth 66 për qind të sasive të parashikuara për këtë muaj.

Kurse në Departamentin e Qymyrit

për këtë muaj ishin planifikuar të prodhoheshin rreth 557 mijë tonë qymyr, ndërsa deri në fund të janarit të këtij viti u prodhuan mbi 526 mijë tonë apo mbi 94 për qind të planit.

Sipas këtyre shënimeve, shihet se gjatë këtij viti në këtë divizion është punuar në kontinuitet me nevojat e Divizionit të Gjenerimit, prandaj edhe plani i parashikuar për këtë muaj nuk është realizuar në tërësi, si në Departamentin ne Djerrinës po ashtu edhe në atë të Qymyrit.

D. Shala

## Punëtorët dhe menaxhmenti i KEK-ut ndanë mbi 33 mijë euro ndihmë Shqipërisë

**T**ë gjithë punëtorët dhe menaxhmenti i korporatës për të ndihmuar sadopak situatën e rëndë të krijuar në veri të vendit nga reshjet e fundit, kanë vendosur t'i bashkohen iniciativës së Qeverisë së Kosovës për të ofruar mbështetje financiare për banorët e Shkodrës me rrethinë të afektuar nga situata e reshjeve. Duke e parë situatën e rëndë që mbizotëron në këtë pjesë, kanë ndarë nga pagat e tyre shumën totale prej 33,572 euro.

Kjo ndihmë vjen pas ndihmës që KEK-u

i ka dhënë korporatës simotër KESH-it, duke marrë energji elektrike aq sa e duron rrjeti i transisionit nga fundi i dhjetorit dhe gjatë janarit. KEK-u dhe KESH-i kanë bashkëpunim të shkëlqyeshëm. Në vazhden e këtij bashkëpunimi KEK-u ka shprehur gatishmërinë e plotë të mbetet në dispozicion për të ofruar çfarëdo mbështetje teknike ndaj KESH-t dhe Shqipërisë në këto momente të vështira, në mënyrë që të vazhdojë të japë ndihmën për tejkalimin e kësaj situatë.

**Departamenti për Komunikime**

# Investitorët shfaqën interesim serioz për projektin “Kosova e Re”



**P**rojekti i shumëpërfolur “Kosova e Re” edhe njëherë shprehu interesin për investitorë në Konferencën e donatoreve, që u mbajt më 20- 21 janar në Prishtinë.

Në konferencë morën pjesë rreth 50 investitorë nga vende të ndryshme të botës, si nga India, Kina SHBA-ja dhe Evropa. Investitorët pjesëmarrës ishin investitorë të rinj dhe nga konsorciumet paraprake. Ata kanë ardhur këtu të shohin në praktikë parakushtet për punë dhe kanë bërë diskutime rreth kësaj çështje.

Në këtë konferencë, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaci, tha se ky projekt ka rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik të vendit. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike nga linjiti, është jetik për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit energjetik dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Gjithashtu, ai ka premtuar se i gjithë procesi për ndërtimin e këtij termocentrali do të jetë legal, i hapur, transparent, në mënyrë të inkurajimit të investitorëve

të fuqishëm botërorë.

Kurse, Ministria Shiroka – Pula, para investitorëve shpalosi edhe njëherë ofertën e saj për projektin më të madh në sektorin energjetik. Ajo tha se vetë pjesëmarrja e investitorëve të huaj në këtë konferencë tregon se sa i rëndësishëm dhe atraktiv është Kosova për investitorë, të cilët dëshirojnë të investojnë këtu. Ministria gjithashtu tha se përzgjedhja e investitorit nuk është e lehtë dhe duhet të bëhen negociata edhe për 17 marrëveshje të ndryshme dhe ky projekt do t’i plotësojë të gjitha kriteret për mbrojtjen e ambientit ndaj BE –së. Në fund ajo informoi se po bëhen gati për një konferencë tjetër ndërkombëtare për Hidrocentralin e Zhurit

Në shkurt të këtij viti do të mbyllet shprehja e interesit për projektin “Kosova e Re”, kurse përzgjedhja e investitorit pritet të bëhet në muajin shtator të këtij viti, ndërsa ndërtimi i këtij termocentrali pritet të fillojë në vitin 2011.

Ky projekt është duke u zhvilluar në

bashkëpunim me Bankën Botërore, Komisionin Evropian dhe USAID-in. Gjithashtu, këtu u tha se Kosova ka potencial për këtë sektor dhe se mund të jetë një vend eksportues i energjisë elektrike.

Edhe investitorët pjesëmarrës në këtë projekt e cilësuan si serioz dhe interesant, kurse përfaqësuesi i Bankës Botërore, tha se e mbështesim këtë projekt për ngritjen e kapaciteteve të reja që do të plotësojnë nevojat e Kosovës për energji elektrike.

Ndërtimi i këtij termocentrali pritet të kushtojë prej 700 milionë deri në një miliard euro dhe nderimi pritet të jetë në dy faza, në 500 plus 500 megavat energji elektrike.

Pas përfundimit të konferencës investitorët vizituan minierat dhe termocentralet e KEK-ut dhe lokacionin ku planifikohet të ndërtohet termocentrali i ri. Ata gjatë kësaj vizite shoqëroheshin nga menaxheri i këtij projekti, Lorik Haxhiu, i cili u përgjigj në të gjitha pyetjet e parashtruara nga të interesuarit.

D. Shala

## U.S.A ambassador visits KEK

Christopher William Dell, United States Ambassador in Kosovo, on 26 January 2010 has visited Kosovo Energy Corporation. He met with the Chairman of the Board of KEK, Mr. Fadil Çitaku, Managing Director of KEK, Mr. Arben Gjukaj and other members of management, and during this event he also visited mines and Kosova A&B power-plants.

During his visit, Ambassador Dell has expressed interest regarding recent improvements that management of KEK has made in the performance of the company that resulted in the stabilization of energy supply in Kosovo, something the citizens of Kosovo have not experienced since 1999.

He was informed that KEK was diligently working during the last two years to open South-West Sibovc mine, which will start its coal production before the foreseen deadline, in mid 2010. Ambassador Dell was also informed about the reactivation of the A4 unit of PP "Kosova A", a step that added necessary capacity for the electricity supply of customers of Kosovo.

Regarding the commercial side of the operations, KEK is focused on improving the flow, billing and collection of electricity. Ambassador Dell was satisfied

when informed that KEK has steadily improved the collection of his customers, from 51% of available energy in 2006 to 65% in 2009 (an improvement of 30%). This has also increased collection during the same period from € 96 million to € 160 million. Those improvements are the result of improved internal controls and monitoring of the performance of workers on the individual basis. In addition, measures for continuous strengthening and enhancing of internal controls of KEK are taken, in order to improve business and price efficiency, the performance of workers and corruption reducing.

"This visit of our American friends is a great support and an additional motive for us to continue working to advance the company in even higher levels," said Managing Director of KEK, Mr. Arben Gjukaj.

Another important performance of the Management of KEK in 2009 was regulation of KEK's report with minority communities. So far, KEK has applied agreements for the regulation of electricity service with all minority communities up to the south of the Ibër River, which means that customers of these areas are now registered as KEK's customers and have begun to pay for

electricity spent. This is a historical achievement, as KEK was unable to collect cash or operate in these areas for 10 years.

In the next 12 months, KEK will not only work in advancing the recent successes, but will also speed up the preparations for restructuring and legal unbundling of the distribution business, a process which is ongoing, and will separate its mining and generation assets, in accordance with Governments policy to prepare the company for privatization.

United States have continuously stressed the objective to help Kosovo to create a stable, democratic and economically stable state in Europe. Assistance programs of the U.S.A Government are designed to help in the achievement of this goal, by working in main fields as energy sector. U.S.A government has supported the energy sector in Kosovo since 1999. This support is currently ongoing through its experienced advisers in KEK, the Energy Regulatory Office and the Ministry of Economy and Finance. In its latest strategic assessment, USAID foresees continuous support to the energy sector, in order to allow a stable electricity supply to Kosovo in terms of growing economic development.



## Stable Conditions of Production in the PP “Kosova B”

## The Coal Division operation was pursuant to the needs of power generation

Units B1 and B2 met, and even exceeded, the electricity generation plan for January 2010. Works were carried out with a great commitment to achieve good results and by complying with the technical conditions of these units.

The work dynamic of both blocks during January, was stable since there was only one stoppage, but without any forced outage.

Based on the data provided by Power Plants Analysis Service, the foreseen generation plan for January for both units was 313,038 megawatts, while the current performance was 358,365-megawatt hours of electricity. From this gross generation, auxiliary use 38336 megawatts, and thus the net generation in B1 unit was 153,671 megawatts of electricity, or 103.4%, while in the unit B2 166,358 megawatts

of electricity, or 101.2%, respectively in the two blocks generation had reached 320,030 megawatt hours of electricity, or 102.2 percent of the plan.

For the generation of this electricity during January 2010, 260,144 tons of coal were burned, based on the data provided from this Service. In both units within this month 590.7 tons of heavy oil is spent for generation needs, building installations, restarts and other needs.

After a long work and a severe winter, by risking production installments during the operation, enough electricity for the supply of the country was provided. Because of the operation in low temperatures and constant frost, it is understandable that the B1 and B2 unit will need repair during this summer, note the engineers.

**B. Rudhani**

Coalmines, during January have produced sufficient quantities of overburden and sufficient coal for the needs of power plants.

According to the Engineering Survey Department of Coal Division, the Overburden Department from the planned removal of 660 thousand cubic meters of overburden, has removed 437 thousand tons or about 66% of the plan.

While in Coal Department from the planned output of 557 thousand tons of coal, only 526 thousand tons or 94% was actually realized.

According to these data, it is apparent that this division has been operating during this period in accordance with the needs of Generation Division, and hence why the foreseen plan for Overburden and Coal Department was not completely fulfilled.

D. Shala

In the Supply Division

**15,076,201  
Euros  
Collected  
During  
January**

The effort of Supply Divisions to collect as much revenues as possible for the electricity spent by consumers continued during January of this year.

Nexhmedin Gashi, the Billing Department Manager, reported following collections results concerning January: Prishtina - €4,524,372, Prizren - €2,189,961, Peja - €1,448,434, Ferizaj - €1,605,032, Gjilan - €1,262,496, Mitrovica - €744.972 and Gjakova - €1,315,588.

The total amount of collection recorded in the CCP is 13,090,855; while €1,985,346 were collected from costumers in 110 kV level of supply. So, the collection during January 2010 was in total 15,076,201 euros, while compared with the same period of the previous year, this month's performance is 22.13% higher, said Gashi.

**F. Ramadani**

## “Kosovo A” starts this year without noted problems



**T**he operation of the PP “Kosova A” units during January was without big problems and no stoppages. This was achieved thanks to timely intervention of the workers in the elimination of different damages and failures that occurred in all electricity generation sectors. During this month, in the power plant mainly two units were operating, while another unit was on standby.

A3 Unit has been working for 300hrs and provided a production of 21045 megawatt/ of electricity, while A5 block was in the operation for 458 hrs and has provided a production of 57813 megawatt/hrs of electricity. In unit A4 was worked mainly on the exchange of the regulatory and command parts of electric filters, which during these work days of the unit are subjected to test. Their operation is followed by our experts and in collaboration with those of the “Siemens” the manufacturers of these devices.

In this unit, protections of the generator's T4 transformer and the self-consumption transformer T4 were also replaced. Unit was started on January 25 and during testing, these protections were shown as successful as reacted in accordance with their design parameters.

Protections are “SIPROTEC” type produced by Siemens.

The PP “Kosova A” has produced in total 116, 828 MW/h of electricity.

Units A3 and A5 had no forced outages, while unit A4 had tripped off during the trial period from this month's installed protections.

Units did however have planned outages during the flooding period in Albania and as Kosovo was supplied with electricity from Albanian's hydro-power-plants.

Ismail Simnica, an expert on technical issues in this power plant, provided all these information.

D.Shala

# The Investors showed serious interest for the “Kosova e Re” project



The most controversial project “Kosova e Re” once again ignited the interest of investors at the donor conference, which was held on 20-21 January in Prishtina. About 50 investors from different countries of the world, as from India, China, USA and Europe attended the conference. Participating investors were new investors and previous consortia. They came here to see closely the preconditions and have discussions regarding this issue. Kosovo Prime Minister Hashim Thaçi said during his speech in this conference, that this project bears a great importance for the country’s economic development. Construction of new capacities for electricity generation from lignite is very important for smooth and sustainable development of energy sector and creation of new jobs. He also has pledged that whole process of this

plant construction will be legal, open, transparent and very encouraging for strong global investors. While Minister Shiroka-Pula once again tendered her offer for the energy sector’s largest project. She said that the participation itself of the foreign investors on this conference is a token of the importance and attractiveness of Kosova for them and others who want to invest here. The Minister also said that the selection of the investor is not easy and the negotiations for 17 different agreements should be provided, and that this project is going to meet all criteria regarding environmental protection of the EU. In conclusion, she informed that they are getting ready for another international conference for hydro-power-plant Zhuri. In February of this year the expression of interest for the project “New Kosovo” will be closed and the

selection of the investor is expected to take place in September of this year and the construction of this plant is expected to begin in 2011.

This project is being developed in collaboration with the World Bank, European Commission and USAID. In addition, it was mentioned that the Kosovo has potential for this sector and that it may become an exporter of electricity.

The investors that participated in this project described it as serious and interesting, while the World Bank representative said that they are supporting this project for the establishment of the new capacities in order to meet the needs of Kosovo for electricity.

Construction of this plant is expected to cost 700 million to one billion euros and the construction is expected to be developed in two stages, in 500 plus 500 megawatts of electricity. Minister Shiroka-Pula said that this is going to be a transparent process and she announced that they are getting ready for another international conference regarding hydro-power-plant Zhuri. After the conference was over the investors visited the mines and the power plants of KEK and the planned location of the new power plants construction. During this visit they were accompanied by the manager of this project, Lorik Haxhiu, who answered on all questions of the interested parties.

D. Shala

# Realizimi i objektivave - synim permanent



Selman Hoti

**E**dhe gjatë vitit 2009 punëtorët e këtij departamenti kanë qenë mjaft aktivë dhe profesional në implementimin e projekteve të parapara sipas planit, tha Selman Hoti, menaxher i Departamentit për matje të energjisë elektrike në Divizionin e Rrjetit.

Ndër projektet që mund të veçohen, e që realizohen nga ky departament janë: “Projekti i vendosjes së pikave matëse në të gjitha daljet 10kV” dhe “Projekti i montimit të komunikatorëve”, që mundëson leximin në distancë të daljeve 10kV, si dhe mundëson rritjen e performancës së klasit të saktësisë në nivel të kësaj matjeje.

Po ashtu, projekt me rëndësi, që sipas planit duhet të fillojë së shpejti të realizohet, është “Projekti i montimit të pikave matëse të konsumatorëve komercialë”, me ç’rast do të vendosen rreth 1500 grupe matëse, të avancuara dhe me një performancë dhe aftësi të leximit nga distanca.

Gjatë kësaj periudhe është punuar



në “Projektin e pikave matëse të vendosjes së konsumatorëve të amvisërisë”, që është përfshirë në të gjitha distriktet me një sasi të vogël të njehsorëve me lexim dhe komandim nga distancë. Edhe në Distriktin e Prishtinës, përkatësisht në lagjet “Arbëria” dhe “Kodra e Trimave” janë montuar rreth 2200 njehsorë elektrikë për lexim dhe komandim nga distanca. Pra, nga objekti i KEK-ut në Prishtinë bëhet leximi dhe komandimi i këtyre njehsorëve, pa pasur nevojë të shkojë punëtori i KEK-ut në shtëpi për ta lexuar apo shkyçur në rast të mospagesës së borxhit, thotë Hoti.

Duke parë se ky projekt është shumë i rëndësishëm dhe mundëson avancimin e pikave matëse me performancësaj, si: klasinesaktësisë, aftësinë e leximit nga distanca, mundësinë e shkyçjes dhe rikyçjes nga distanca, si dhe mundësinë e

limitimit të nivelit të shfrytëzimit të energjisë elektrike. Përveç kësaj, ky projekt ka ndikim të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e humbjeve të energjisë elektrike, sidomos humbjeve komerciale. Gjithashtu, ky projekt ka bërë që në të ardhmen Divizioni i Rrjetit të vazhdojë të ketë në planin e tij shtrirjen e mëturjesme të të gjithë konsumatorëve, vazhdoi ai.

Gjatë vitit 2009 ka pasur të arritura evidente sa i përket zhvillimit të projekteve mjaft indikativë dhe të domosdoshëm, veçmas në Departamentin për Matjen e Energjisë Elektrike, por në përgjithësi edhe në Divizionin e Rrjetit.

Ndërsa, për vitin 2010 do të bëjmë përpjekje maksimale për arritjen e objektivave të parashtruara dhe rezultateve edhe më të mira, përfundon Hoti.

F. Ramadani

## Projektet themelore fokusohen në regjistrimin e konsumatorëve të përkohshëm dhe atyre paushall



Fadil Begu

**U**dhëheqësi i Shërbimit për Matje Teknike në Distriktin Prishtinës, Fadil Begu, tha se ky shërbim ka të punësuar 28 punëtorë, të cilët kanë një përvojë të shkëlqyeshme dhe për vitin 2009 kanë përbushur të gjitha objektivat e paraparë me plan. Gjatë vitit 2009 janë regjistruar afro 6,300 konsumatorë të rinj, janë bërë rreth 5,300 ndërrime njehsorësh, janë regjistruar mbi 95 konsumatorë komercial me fuqi instaluese mbi 15 KW, si dhe janë evidencuar dhe regjistruar të gjithë konsumatorët nëpër enklavat serbe, që janë në Distriktin e Prishtinës. Në këtë punë, përveç punëtorëve tanë kanë marrë pjesë edhe punëtorë nga shërbime tjera të KEK-ut, por punën kryesore e ka bërë shërbimi jonë.

Gjithashtu, janë ndërruar njehsorët e vjetër me të rinj, kështu vetëm në fshatin Prilluzhë janë ndërruar mbi 400 njehsorë, rreth 100 njehsorë në fshatin Gracë dhe e njëjta punë është duke vazhduar edhe në Graçanicë. Njëherësh, janë bërë mbi 140 lidhje të reja me instalime të reja në rajonin e Drenasit, sidomos për familjet skamnore. Kanë përfunduar instalimet dhe montimet e 132 njehsorëve në Kampin "Lagja e Kuvajtit" në Besianë, por edhe për 23 familje skamnore në Kishnicë të komunës së Artanës, tha ai.

Objektiv kryesor i Shërbimit për Matje Teknike në Distriktin e Prishtinës është që deri në fund të vitit 2010 të gjithë

konsumatorët të pajisen me njehsorë, njëherësh të zvogëlohet në minimum edhe koha e realizimit të kërkesave në mënyrë që konsumatorët e KEK-ut të jenë të kënaqur me shërbimet e tij.


Por, përkundër këtyre rezultateve të prekshme gjatë punës së përditshme këtë shërbim e përcjellin ca vështirësi, sidomos ato të natyrës subjektive. Edhe pse ky shërbim ka nevojë për dy automjete terreni, vullneti për punë i punëtorëve nuk ka munguar asnjëherë.

Duhet përmendur, sidomos mbështetjen dhe përkrahjen e drejtorit të Divizionit të Rrjetit, Avni Alidemaj dhe të drejtorit të Divizionit të Furnizimit, Naim Sahiti, të cilët në vazhdimësi kanë mbështetur punëtorët e këtij shërbimi vetëm që puna të mos ngec dhe të ketë rezultate më të mira.

Shërbimi për Matje Teknike tani për tani është i angazhuar në dy projekte: "Regjistrimin e konsumatorëve të përkohshëm" dhe "Regjistrimin e konsumatorëve paushall". Edhe këto dy projekte janë në përfundim të fazave të para dhe ka rezultate të mira. Por, vështirësi kryesore në këtë punë është numri i vogël i ekipeve në raport me nevojat. Pra, këto dy projekte kërkojnë më shumë ekipe punëtorësh sesa është planifikuar.

Në fund, Begu tha se është shumë i kënaqur me stafin e tij, sepse kanë krijuar besim të ndërsjellë. Nëse do të ketë edhe më tej përkrahje të duhur logjistike dhe materiale, do të ketë edhe rezultate. Punëtorët nuk janë të kënaqur me pagesën për punën e tyre, veçanërisht sektorët ku përgjegësia dhe profesionalizmi kërkohen më shumë. Do të ishte e udhës që pagesa e tyre të rishqyrtohet dhe këta punëtorë të paguhen sipas kontributit të tyre.

**F. Ramadani**



## In memoriam

Më 21 janar është ndarë nga jeta Prof. Dr. Mehmet Begraca, veteran i mjekësisë në Kosovë, themelues i Mjekësisë së Punës në vendin tonë, profesor që nga themelimi i Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, ish-ministër (sekretar) i Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës dhe deputet në periudhat para vitit 1980.

Vdiq në moshën 76- vjeçare, gjithnjë i nderuar e i respektuar nga kolegët, ish-studentët e tij dhe publiku kosovar, nga i cili asnjëherë nuk u nda dhe nuk e zhgënjeu. Për meritat e tij dëshmon edhe fakti se Instituti i Mjekësisë së Punës në Kastriot, kohë më parë, për të gjallë të tij, propozoi që ky institut të bartë emrin e themeluesit, "Dr. Mehmet Begraca". I ndjeri është nderuar me shumë mirënjohje profesionale e publike dhe është autor i një vargu punimesh shkencore të publikuara në vend dhe në botën e jashtme. Me rastin e vdekjes së tij, në Fakultetin e Mjekësisë është mbajtur një mbledhje komemorative, kurse varrimi është bërë në vendlindjen e tij në Gracë të Kaçanikut.

**Me pikëllim të thellë e përkujtojnë:  
Punëtorët e KEK-ut dhe IMP-së**

## Punohet pandërprerë dhe në kushte të jashtëzakonshme

**N**ë këtë nëndistrikt punojnë dy epike të mirëmbajtjes prej 7 punëtorësh. Njëri ekip punon në ndërrimin e parë, ndërsa ekipi i kujdestarisë punon deri në ora 24:00. Në raste të jashtëzakonshme të ndonjë prishje apo avarie më të madhe intervenohet edhe pas këtij orari, thotë Jahush Dragusha, koordinator për mirëmbajtje në Kastriot.

Ky nëndistrikt përfshin komunën me fshatrat: Mazgit, Shkabaj, Milloshevë, Babimovc, Gracë, Stanovc i Epërm, Stanovc i Ulët, Lumë i Madh, Prilluzhë, Plemetin, Bakshi, Raskovë, Lazarevë, Bivolak, Glavotinë, Strovç, Beçuk, Grabovc, Hamidi, Hade, Lajthishte, Palaj, Zhilivodë, Sibovc dhe Shipitullë, të gjitha këto vendbanime me rreth 7500 konsumatorë.

Rrjeti nuk është në gjendje të mirë, është i vjetruar, ndërsa shumica e shtyllave janë të drunjta mbi 40 vjet. Ndërsa, intervenimet në terren varen kryesisht nga prishjet, sidomos gjatë përkeqësimit të motit. Ka ndodhur që



Jahush Dragusha me kolegët e punës

gjatë një dite të ketë 100 deri në 200 prishje. Ekipet janë të pajisura me të gjitha mjetet e punës dhe në këtë drejtim nuk kanë ndonjë problem. Edhe pse kanë në dispozicion tri automjete të lehta, ata kanë nevojë të madhe për një kamion-shportë dhe një ekskavator. Vlen të theksohet se më 9.01.2010 kishte erëra të forta dhe këto kishin shkaktuar thyerjen e 40 shtyllave, këputjen e telave të rrjetit, kishin djegur siguresat dhe të gjithë largpërçuesit kishin dalë jashtë punës. Brenda dy ditësh ekipet e mirëmbajtjes kishin arritur të sanonin këto prishje. Kjo tregon se këto epike janë të përgatitura edhe për raste të jashtëzakonshme. Gjithashtu, në këtë nëndistrikt ka pasur edhe investime të konsiderueshme si në

TS 35/10kV me 8 MGA në Palaj, që ka mundësuar furnizim më kualitativ me rrymë për konsumatorët. Pastaj në bashkinvestim me konsumatorët, kanë arritur që mbi 70 për qind të ngritin kapacitetin e trafave, duke mundësuar furnizim më kualitativ. Në fshatin Sibovc është ndërtuar largpërçuesi prej 1.5 km me një trafoblindë. Po ashtu, në fshatin Gracë së bashku me DFID-in anglez është ndërtuar largpërçuesi prej 1 km. Ndërsa, rreth 80 për qind të trafave të këtij nëndistrikti janë të pajisura me ndërprerës për mbrojtje të tensionit të ulët. Mirëpo, përkundër këtyre punëve dhe investime ky nëndistrikt ka ende nevojë për investime shtesë, tha Dragusha.

F. Ramadani

## Sulmohen punëtorët e KEK-ut në detyrë

**P**ara disa ditësh punëtorët e KEK-ut, Bekë Nikqi, Bashkim Zekaj, Gëzim Gashi dhe Zenun Shala, janë sulmuar gjatë vizitës te konsumatori NTB "Bibita" në Vitomiricë të Pejës.

Rasti kishte ndodhur pasi ekipi i KEK-ut po bënte kontrollin e pikave matëse të konsumatorëve të mëdhenj, me qëllim të luftimit të humbjeve komerciale, përkatësisht vjedhjes të energjisë elektrike.

Pasi kishin vizituar 13 konsumatorë, punëtorët kur i ishin lajmëruar punëtorit të sigurimit të kësaj kompanie se janë nga KEK-u, ai nuk e kishte lejuar matjen, përdërisa edhe ekipi ishte kërcënuar.

Punëtorët menjëherë kanë njoftuar për kërcënimin, ku Policia e Kosovës kishte mbërritur në vendin e ngjarjes. Por, punëtorët janë sulmuar fizikisht të gjithë në prezencë të organeve të rendit, ndërsa më keq kanë pësuar punëtorët Gëzim Gashi dhe Zenun Shala. Më pas të gjithë punëtorët për shkak të lëndimeve është dashur të shkojnë në Qendrën Emergjente të Spitalit të Pejës për të kërkuar ndihmë mjekësore. Me rastin po merren organet e hetuesisë.

KEK -u dënon ashpër këtë sulm ndaj punëtorëve në detyrë, shpreh indinjatën e thellë tek organet e rendit pasi sulmi ka ndodhur në prani të policisë, kërkon nga

organet e rendit që përfaqësuesit e tyre të jenë në nivel të detyrës, në mënyrë që të mos përsëriten më raste të tilla dhe apelon tek institucionet kompetente që të ndërmarrin masa të rrepta ndaj sulmuesve, për të marrë dënimin e merituar.

KEK-u shpreh përkrahjen e plotë për punëtorët, të cilët kryejnë detyrat e tyre dhe do të mbrojnë performancën e tyre në rrugë ligjore.

Korporata është e vendosur në luftën kundër vjedhjeve dhe keqpërdorimeve tjera nga konsumatorë e pandërgjegjshëm dhe nuk do të ndalet deri në evidentimin dhe evitimin e keqpërdorimit të fudit.

Departamenti për Komunikime

## Operatori më i vjetër në Prishtinë



Hikmet Qafleshi në KEK ka mbushur 32 vjet përvojë pune. Shtatë vjet radhazi ka punuar arkëtar, ndërsa 25 vjetët e fundit punon si kryeoperator në TS 35/10 kV në Prishtinë.

Ai tha se tani për tani ka mbetur operatori më i vjetër në Distribucionin e Prishtinës. Puna e tij është mjaft e përgjegjshme, sepse ka të bëjë me shkycjen dhe reduktimet e daljeve, atëherë kur kërkohet nga kujdestaria e KEK-ut, si për ndonjë intervenim në pajisje apo edhe për reduktime të energjisë. Vendi i tij i punës kërkon një vigjilencë dhe syçeltësi, sepse një gabim më i vogël mund të kushtojë me jetën e ndonjë punëtori të KEK-ut.

Hikmeti tha se për momentin nga kjo trafo, e cila gjendet përballë ndërtesës së Elektrokosovës nuk ka shkycje apo reduktime, sepse të gjithë konsumatorët që furnizohen nga kjo trafo janë në grupin A dhe tri dalje janë në grupin A+. Në këtë grup janë: "Ndërtesa e KEK-ut dhe e PTK-së", "Qendra e Studentëve" dhe "RTK-ja". Ai tha se të gjithë punëtorët që punojnë në këtë trafo janë të pajisur me mjete të duhura të punës dhe në këtë drejtim nuk kanë asnjë problem. Por një pakënaqësi e vogël e tyre është se edhe pse para 5 muajsh kishte një barazim të pagave në mes operatorëve të TS 35/10kV dhe të atyre 110/10 kV, ndërsa nuk kishte ngritje të pagave të kryeoperatorëve të tyre. Ato kanë mbetur të njëjta edhe pse ka raste ku nëpër trafot 35/10 kV ka më shumë punë se në TS 110/10 kV. Kjo duhet të përmirësohet në të ardhmen, përfundoi Qafleshi.

F. Ramadani

## Punëtor dhe sportist i dalluar



Avni Shala është punëtor i ri në KEK, por me përvojë të gjatë paraprake. Qysh si i ri interesimi i tij për t'u shkolluar ka qenë mjaft i madh. Fillimisht ai ka mbaruar Shkollën e Lartë Pedagogjike - Drejtimi Gjuhë dhe Letërsi në Prishtinë, për të vazhduar pastaj në Fakultetin Juridik, ku dhe merr titullin Jurist i Diplomuar. Ndërkohë, ka kryer edhe Kodin e Etikës për Gjyqtar dhe Prokuror. Para se të punësohet në KEK, Avniu ka punuar në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë. Kurse në KEK punon zyrtar ligjor në Departamentin për Përkrahjen e Prokurimit, përkatësisht në Zyrën Ekzekutive të Prokurimit. Krahas punës së tij intelektuale, ai në vazhdimësi është marrë edhe me sport, kryesisht me futboll. Nga viti 1991-92 ka mbrojtur ngjyrat e ekipit "Drenica" nga Skënderaj, ndërsa në vitin 1997 ka luajtur për ekipin " 2 Korriku" nga Prishtina. Aktualisht është pjesë e ekipit të futbollit të vogël të KEK-ut, i cili ekip në vitin 2009 në garat e punëtorëve të Kosovës, zuri vendin e tretë. Sipas kolegëve të tij, për këtë sukses, më i merituari ishte Avniu, i cili edhe shpallet portieri më i mirë i këtij turniri.

D. Shala

## Punëtorja që dëshiron ngritje të performancës së KEK-ut



Nizafete Dubova punën në KEK e ka filluar para 22 vjetësh. Së pari ka punuar në Distribucionin e Gjilanit rreth 19 vjet, ndërsa në tre vjetët e fundit është duke punuar

në Departamentin për Përkujdesje ndaj Konsumatorëve, përkatësisht në Divizionin e Furnizimit në Prishtinë.

Ajo është punëtoreshë mjaft e veshme dhe të gjithë kolegët e saj të punës kanë vetëm fjalë të mira për te, si në punë, po ashtu edhe në raportet e tyre ndërshoqërore.

"Gjatë përvojës 22- vjeçare në punë deri më tani nuk kam pasur as problemin më të vogël me askënd", thekson ajo.

Derisa punonte në sportel, vëreheshin radhët e konsumatorëve, të cilët i drejtoheshin asaj lidhur me kërkesat apo ankesat e tyre, që një nga një i trajtonte me një disiplinë dhe përkushtim të theksuar. Për këtë ishim dëshmitarë dhe nga vetë konsumatorët dëgjoreshin fjalë të mira për këtë punëtoreshë.

Ajo shtoi se vendi i saj i punës është në regjistrimin e të gjitha rasteve të lidhjeve të reja, pastaj në regjistrimin e rasteve të ndërrimit të grupeve matëse. Por shpesh i ka ndodhur të punojë edhe në sportelin për përkujdesje ndaj konsumatorëve, kur paraqitet nevoja.

Në zyrën ku punon Nizafetja ka një volum të madh të punëve, ndërsa më vështirë është regjistrimi i shënimeve të grupeve matëse, sepse kjo merr shumë kohë. Për këtë shkak ajo punon gjashtë ditë në javë, pra është detyruar të punojë edhe çdo të shtunë deri në ora 12:00, në mënyrë që të kryhen sado kudo punët e mbetura gjatë së kaluarës. Edhe pse kjo paguhet për këto orë, pagesa nuk është ndonjë shumë që vërtet do të shpërblente mundin e saj.

Ajo tha se ka të kryer Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe dëshira e saj është që të ketë një organizim edhe më të mirë të punëve, të ketë ngritje të performancës së KEK-ut, por edhe plotësim të kushteve të punëtorëve, në mënyrë që të jenë të kënaqur me punën dhe shpërblimin e tyre.

F. Ramadani

# Bashkim Paçuku fiton çmimin “Barry Alexander”



Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, tenori shqiptar, Bashkim Paçuku, një zë dhe emër i njohur i skenës botërore, ka fituar çmimin e parë në konkurrimin për çmimin ndërkombëtar për këngëtarët klasikë “Barry Alexander” . Shqiptaro-amerikani nga Dibra e Madhe, Bashkim Paçuku, ka një karrierë të gjatë dhe të suksesshme, që e ka filluar në Ballkan, fillimisht në Shkup, ku ka kryer studimet, pastaj në Kosovë, Kroaci, e më pas është shtrirë në disa vende evropiane: në Itali, ku ai ka interpretuar në teatrin “La Scala”,

në Moskë, në teatrin “Çaikovski” dhe në vende të tjera evropiane, si Spanjë, Francë, Austri, Gjermani. Që prej vitit 1990 Paçuku ndodhet në Shtetet e Bashkuara, ku ai ka studiuar, kurse tani jep mësim në Universitetin e Bostonit. Këtu ai ka fituar këto ditë çmimin parë në konkurrimin për çmimin ndërkombëtar për këngëtarët klasikë Barry Alexander. Më 24 janar të këtij viti ai interpretoi në sallën e famshme “Carnegie Hall” të Nju -Jorkut në një recital në kuadrin e këtij konkurrimi.

Përgatiti: D. Shala

## MIKES SIME!

Emine Mehani

Vetëm Ti e di peshën e këtyre vargjeve!

Vetëm Ti i njeh vetëtimat e mia!

Fjala dhe vepra jote njerëzore

Melhem shërues që bie mbi plagë,

E varre nuk hap, e nuk le vrragë!

Ndejat me ty janë si takim me lulet

Që presin qetë kurorë për të hapë

Ti më mësove si të luftohen gënjeshttrat

Frika më nuk ekziston

Drita e shpirtit të zbardhon.

Ti mikja ime ndonjëherë dhembshëm qesh...

Që askush të mos e ndjejë,

Vuajtjen dhe dhimbjen tënde!

Krenohem që të kam mike,

Fundi nuk është i yni,

As kur vdesim,

Nuk do të ndahemi përgjithmonë.

## 17 SHKURTI

Lum Kosova për djemtë e vet

Luftuan me nder dhe bën shtet

Për liri s’u ndalën kurrë

Të kemi atdhe, të kemi flamur.

Sa shumë derdhëm gjak e lot

Shumë miq krijuam n’botë

Tok me ta fituam lirinë

Tani ndërtojmë ardhmërinë.

Shtatëmbëdhjetë shkurt dymijë e tetë

Dita e artë me t’vërtetë

Hej, delegatët mbajtën kuvend

Shpallën Kosovën shtet përnjëmend.

E gjithë bota e mahnitur

Me flamur Kosova e ngritur

Populli festoi PAVARËSI

Në përrurimin e shtetit më të ri.

Prishtinë, 22.02.2008, Ismail Simnica

# Botime të reja



Pas botimit të monografisë “ Kohë e ndaluar “, Bedri Neziri boton edhe librin e tij të dytë, një përmbledhje me poezi, të titulluar “ Shtegtimet e Arbrit”, që doli nga shtypi në fund të vitit 2009. Poeti Bedri Neziri, është një ndër themeluesit e grupit letrar të SHKA “ Rruga e Lirisë” e më vonë edhe i klubit letrar “ Fahri Fazliu” në Kastriot, ku edhe është kryetar i këtij klubi. Vargjet e librit “ Shtegtimet e Arbrit” përjetësojnë shtegtimin e historisë së kësaj ndjeshmërie, që i bëhet lajtmotiv gjithë frymëzimit të poetit, të cilat janë vargje që zbusin shpirtin.

Poezia e Nezirit është dialog i realizuar si te shumë poetë tanë tashmë të afirmuar, por ajo që është e re, është mënyra se si realizohet ky dialog dhe emocionit që të zgjon ai.

Poezia e Nezirit shpesh është edhe një

monolog, që ngrihet natyrshëm mbi bazën e një konflikti të brendshëm njerëzor, që ka mbajtur peng poetin kohë të gjatë, për të shpërthyer në kohën kur ai është i përgatitur t’i sfidojë të gjitha tronditjet e atij shpërthimi.

Autori këtu parapëlqen të përgjithshmen ose njerëzoren më sublime, që e

ndërton duke kënduar individualen, që arrin ta përjetësojë me dimensionin e përgjithshmes. Në këtë kontekst mund të përmendim ndjenjën e mallit, që autori i jep dimensionin universal.

Shpresojmë që ky libër do të komunikojë natyrshëm me lexuesin e vet.

Përgatiti: D. Shala

## Fjalëkryqi

### Horizontalisht:

1. Përsosja e diçkaje që u përgjigjet nevojave të kohës.

2. Mbreti i Tebes që u martua me të ëmen; ndryshimi i emrave në rasë.

3. Lloj bime industriale; shoku- jarani.

4. Sportisti kulminant; rend në xhami; pushon (shiu).

5. Simboli i neonit; vend; emri i detarit Marvin.

6. Bashkëtingëllore grykore; hijeshia; tonelatë (shkurt).

7. Njësia e rezistencës elektrike; armë e vjetër për goditje; parafjalë.

8. Mbiemri i aktorit Alan; likuidimi (shkurt); pjesë e lojës në voleyboll apo tenis.

9. Ai që jeton në liri; mal që ndan Evropën nga Azia.

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											

### Vertikalisht:

1. Gjendja shpirtërore e rëndë- trishtim i thellë.

2. Emri i skulptorit Paskali; pyll.

3. Besimi-feja (turq); shkronja e dytë e alfabetit; kam njohuri.

4. Lloj i poezie epike; deminutiv i emrit Lutfi.

5. Parashetë me domethënie; përsëritje veprimi; petriti.

6. Simbol i azotit; i biri i Sulltan Muratit që në luftën e Kosovës është në radhën e Drenicës.

7. Ai (frëngjisht); mbreti i Egjiptit që rrëzoi me grushtshtet Gamal Abdel Naserin, që kishte origjinë shqiptare.

8. Lëndë ngjitesë; Elizabet Tejllor.

9. Shkojmë- largohemi; pyetëse për sasinë.

10. Emër katolik mashkulli; lloj drithi.

11. Vetë mbrojtëse për t'u bërë ballë mikrobeve dhe helmeve.

M.Restelica

Për shkak të vërshimeve të mëdha në Shkodër

# KEK-u ka ndihmuar KESH-in duke marrë energji elektrike

Nga ditët e fundit të dhjetorit dhe gjatë janarit KEK-u ka marrë energji elektrike nga korporata simotër KESH në formë shkëmbimi për aq sa e lejojnë kapacitetet transmetuese.


Për këtë qëllim KEK-u ka ndalur nga puna dy njësi për prodhim të energjisë elektrike në TC "Kosova A", në mënyrë që në Hidrocentralet e Shqipërisë, rezervat hidrike të përdorën sa më shumë për prodhim të energjisë elektrike e të mos humbet uji. Kjo marrëveshje me KESH-in njëkohësisht ka ndihmuar edhe në uljen e rrezikut nga vërshimet e mëdha në Shkodër.

Konkretisht, KEK-u ka marrë varësisht prej orës dhe ditëve deri në 300 MW për orë, apo mbi 5600 MWh brenda 24 orëve, që nga data 26.12.2009. Gjithçka është bërë në bazë të marrëveshjeve KEK-KESH për shkëmbimin e energjisë elektrike.

Energjia e pranuar nga ana e KEK-ut prej Shqipërisë është energji e shkëmbyer dhe nuk paraqet shit-blerje të saj. KEK-u ndër vite bashkëpunon me KESH-in në fushën e shkëmbimeve të energjisë elektrike. KEK-u nuk ka shitur energji elektrike në Shqipëri gjatë muajit dhjetor, përveç kthimit të një sasi shumë të vogël të borxhit në energji KESH-it. Për informimin e drejtë të publikut, KEK-u njofton që bëhet fjalë për një sasi të energjisë fare të vogël, e cila është e barabartë gjatë tërë nëntorit dhe dhjetorit me energjinë elektrike që KEK-u ka marrë nga KESH-i vetëm gjatë dy ditëve në fund të dhjetorit dhe gjatë janarit. Kjo nënkupton që informatat e publikuara në media të ndryshme për sasi të mëdha të energjisë kinse të shitura KESH-it nga ana e KEK-ut janë të pasakta!

KEK-u ka vënë në dispozicion të KESH-it tërë potencialin e vet teknologjik për të ndihmuar në tejkalimin e vështirësive në hidrocentralet e KESH-it, vështirësi që kanë rezultuar nga ngritja e nivelit të prurjeve në Liqenin e Fierzës. KEK-u mbetet thellësisht i angazhuar të ndihmojë edhe në ditët në vijim deri në stabilizimin e gjendjes në hidrocentralet shqiptare.

**Departamenti për Komunikime**



**Paguaj edhe ti  
që të kesh rrymë!**



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh. a.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION I.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.